



## **Përditësim për shtypin**

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, Trupi Gjykses më 10 prill urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Hashim Thaçit pasi konstatoi se ekzistonte ende rreziku që të pengonte ecurinë e procesit ose të kryente vepra penale të tjera.

Trupi Gjykses rikujtoi se kishte konstatuar më parë se z. Thaçi kishte interesin dhe aftësinë të ndërhynte në procesin gjyqësor dhe po përballet me akuza për ndikim të pretenduar te dëshmitarët. Trupi Gjykses rikujtoi se emrat e dëshmitarëve tepër të ndjeshëm nuk duhet t'i bëhen të ditur publikut, as pasi të kenë përfunduar dëshminë, duke mbajtur parasysh se për shumë prej tyre janë miratuar masa mbrojtëse. Në pikëpamjen e Trupit Gjykses, ky rrezik nuk është zvogëluar me mbylljen e paraqitjes së provave në këtë çështje gjyqësore.

Trupi Gjykses theksoi se rreziku i ndërhyrjes përfshin gjithashtu orvatjet për t'u hakmarrë ndaj dëshmitarëve që kanë dhënë dëshmi ose për t'i motivuar dëshmitarët të tërheqin dëshmitë e tyre.

Trupi Gjykses nënvizoi se këto rreziqe ekzistojnë në atmosferën e frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë dhe nuk mund të mënjanohen vetëm me masa mbrojtëse, dhe doli në përfundimin se ato mund të trajtohen në mënyrë efektive vetëm në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara.

Sidoqoftë, Trupi Gjykses mbajti parasysh se z. Thaçi ka një kohë të konsiderueshme që është në paraburgim dhe kjo kërkon që Trupi Gjykses dhe palët të sigurojnë që procesi gjyqësor të vijojë sa më shpejt që të jetë e mundur.

Më 13 prill doli versioni i redaktuar publik i dosjes përfundimtare të z. Krasniqi, që ishte dorëzuar në mënyrë konfidenciale më 20 janar dhe mund të gjendet në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit për ndikim të pretenduar te dëshmitarët, Gjykatësi i Vetëm më 10 prill miratoi kërkesën e Mbrojtjes së z. Kilaj për të pranuar si prova dëshmitë me shkrim të katër dëshmitarëve.

Gjykatësi i Vetëm vlerësoi se dëshmitë në fjalë lidhen me karakterin e të pandehurit dhe nuk janë për vërtetimin e veprimeve dhe sjelljes së të akuzuarit. Gjykatësi i Vetëm vuri në dukje se Prokuroria nuk paraqiti kundërshtime për pranimin e dëshmimeve me shkrim dhe nuk bëri kërkesë për t'i marrë në pyetje ndonjë prej këtyre dëshmitarëve.





Ekipe të mbrojtjes që vendosën të paraqesin prova në këtë çështje, janë duke i paraqitur ato. Gjatë seancës së fundit, palët diskutuan nëse disa dëshmitarë të caktuar duhet të jenë të pranishëm në sallën e gjyqit, apo nëse dëshmia e tyre mund të pranohet me shkrim. Gjykatësi i Vetëm do të vendosë nëse një dëshmitar duhet të japë dëshmi në sallën e gjyqit apo nëse dëshmia mund të dorëzohet vetëm me shkrim. Pasi të dalin vendimet lidhur me këtë aspekt, mund të ketë më shumë informacion edhe sa seanca do të nevojiten para mbylljes së fazës së paraqitjes së provave.

